



FSHF-ja ka bere edhe nje here te ditur nje dite para ndeshjes me Luksemburgun se ne rast fitore me keta te fundit, lojtaret e perfaqesueses kuqezi do te marrin premion e premtuar. Behet fjale per plot 200 mije euro, para keto qe do te shperndahen mes lojtareve dhe stafit. Presidenti Armando Duka, para ndeshjes me Rumanine i kishte kerkuar lojtareve te merrnin nje rezultat pozitiv ne takimin e pare te eliminatoreve dhe gjithashtu te arrinin nje fitore ne ndeshjen e dyte kunder Luksemburgut. Objektivi i pare u arrit, barazimi ne Rumani ishte nje rezultat pozitiv. Tashme per kuqezinjte e drejtuar nga Josip Kuzhe mbetet vetem te fitojne kunder Luksemburgut e me pas do te mund te perfitojne 200 mije eurot e premtuara si shperblim.

Enea Shtrepi